



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit 22.30.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
MAMUSHËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi , i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Kapllan Muhaxheri (Udhëheqës ekipi) Alban Beka dhe Arian Zenelaj (Anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	30
Shtojca III: Letër konfirmim	36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Mamushës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23/11/2017. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Mamushës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës së Mamushës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç mbivlerësimit të buxhetit për paga dhe mëditje për 40,000€, si dhe të hyrave vetjake për 10,000€.

Theksim i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë e komunës nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë si dhe nuk ishin prezantuar në pasqyrat financiare vjetore.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Mamushës. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme, e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklaratat e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte prezantuar gabimisht në vlerë 900,000€, derisa buxheti i ndarë sipas të dhënave të thesarit ishte 860,000€, d.m.th. janë të mbivlerësuar për 40,000€. Me tutje, të hyrat indirekte nga gjobat dhe dënimet e trafikut në vlerë 10,000€, janë prezantuar gabimisht në raportin e ekzekutimit të buxhetit, derisa të njëjtat prezantohen si të hyra nga institucionet që i grumbullojnë ato (Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës).

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në

Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna nuk kishte respektuar kërkesat e rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, përkatësisht nuk kishte evidenca për pasuritë e saj qoftë për ato mbi vlerën 1,000€ ose nën 1,000€. Në mungesë të evidencave kontabël ajo nuk ka shpalosur pasuri as në PFV-të e saj. Në mungesë të evidencave pamundësohet kontrollin efektiv mbi to, si dhe ekziston rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së tyre.

Opinionin ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë; dhe
- Planin e Prokurimit për vitin 2017.

Përpos çështjeve të prezantuara të opinionit i auditimit, ne kemi prezantuar edhe një gabim, tek neni 21 "Raport për të hyrat vetjake të pashpenzuara", ku komuna ka paraqitur vlerën 75,000€ si të bartur për vitin 2018, ndërsa është dashur të paraqitet vlera 71,604€, më diferencë 3,396€.

Duke marrë parasysh atë që u shpalos më lartë dhe në opinionin e auditimit, Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur i janë dorëzuar Pasqyrat Vjetore Financiare Qeverisë, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të cilat janë identifikuar të baza për opinionin e auditimit.

Në këtë kontest të raportimit të jashtëm kemi vërejtur se komuna ka plotësuar kënaqshëm kërkesat për raportim të jashtëm, përveç, vonesave në raportimin e PFV-ve. Komuna nuk ka arritur të raportoj pasqyrat financiare në afatin e paraparë ligjor deri më 30 janar 2018.

2.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura ne japim rekomandimet, si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në prezantimin e buxhetit dhe të të hyrave vetjake, si dhe evidentimin dhe raportimin e pasurisë.

Gjithashtu, kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të dizajnuar një sistem relativisht të mirë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat, megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me të hyrat, prokurimin, dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga Komuna në fushat e përmendura. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime, janë procesi i menaxhimit të shpenzimeve të parasë së imët dhe mbylljes së avanseve, si dhe menaxhimi dhe raportimi i llogarive të arkëtueshme dhe obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,813,399	1,870,828	1,595,791	1,440,614	1,359,737
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,707,573	1,668,835	1,517,996	1,412,667	1,285,758
Të hyrat bartura ² -	-	96,059	71,902	26,742	59,900
Të hyrat vetjake ³	105,826	105,826	5,894	-	1,300
Donacionet e brendshme	-	-	-	1,205	5,600
Donacionet e jashtme	-	108	-	-	7,179

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 57,429€. Ndryshimet nga buxheti fillestar ishin, si:

- Buxheti final, fillimisht është rritur si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2016 në vlerë 96,059€, si dhe donacioneve në vlerë 108€;
- Ndërsa, në fund të vitit në bazë të vendimit të qeverisë për kursimet buxhetore është reduktuar për 38,738€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 85% të buxhetit final ose 1,595,791€, me një përmirësim mbi 10% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,813,399	1,870,828	1,595,791	1,440,614	1,359,737
Pagat dhe Mëditjet	899,615	860,877	834,645	856,690	840,401
Mallrat dhe Shërbimet	198,891	198,908	178,130	227,852	100,327
Shërbimet komunale	23,000	23,000	22,819	22,953	22,943
Subvencionet dhe Transferet	6,466	6,466	6,350	2,400	3,000
Investimet Kapitale	685,427	781,576	553,847	330,719	393,066

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Tek kategoria e pagave dhe mëditjeve buxheti ishte reduktuar për 38,738€. Arsyeja e reduktimit ishte largimi i gjashtë drejtorëve të drejtorive nga lista e pagave për shkak të aktiviteteve politike gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2017 (tetor – dhjetor 2017);
- Pavarësisht rritjes prej 96,149€ të buxhetit për shpenzime kapitale, realizimi për këtë kategori është shpenzuar vetëm 71% e buxhetit; dhe
- Buxheti për mallra dhe shërbime, shërbime komunale si dhe subvencione dhe transfere nuk kishte ndryshime krahasuar me buxhetin fillestar.

Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të buxhetit të investimit kapitale

E gjetura Ekzekutimi i ulët lidhur me investimet kapitale është sfida kryesore me të cilën përballlet komuna. Vetëm 71% e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar dhe çështja nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit edhe pse ajo është trajtuar në raportet e mëparshme të auditimit (në vitin 2016 ishte 76%). Për me tepër dinamika e realizimit nuk ishte në harmoni me planifikimet, sepse 51% e shpenzimeve ishin realizuar në tremujorin e fundit të vitit.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm. Në anën tjetër niveli i lartë i shpenzimeve kapitale në fund të vitit rrezikon që pagesat t'i shmangen kontrolleve të duhura të procesit të ekzekutimit.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë që përformanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin 42,798€. Komuna ende nuk ka të vendosur kontrolle të brendshme efektive që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë agregimin e tyre në PFV.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 ⁴ Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	105,826	105,826	42,798€	56,243	52,763

Gjatë vitit 2017, komuna, kishte arritur të realizoj vetëm 42,798€, ose 40%. Në këtë vlerë nuk janë paraqitur edhe të hyrat indirekte, si: hyrat nga gjobat e trafikut në vlerë 9,518€ si dhe gjobat nga gjykata në vlerë 1,025€.

Të hyrat vetjake janë shpenzuar kryesisht për projekte kapitale 95%, pjesa tjetër prej 5% është shpenzuar në kategorinë e subvencioneve.

⁴ Pranimet për 2016 dhe 2015 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

Çështja 3 - Menaxhim jo adekuat i të hyrave nga tatimi në pronë

E gjetura Gjatë vitit 2017 ishin inkasuar të hyra nga tatimi në pronë në vlerë 19,184€ (shuma prej 7,893€ ishin arkëtime nga faturimi i vitit 2017), derisa faturimi vetëm për vitin 2017 ishte 31,282€. Komuna nuk ka aplikuar ndonjë qasje pro aktive për mbledhjen e tatimit në pronë.

Me tutje, Zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin (ri-anketimin) në teren të 1/3-ës së pronave të regjistruara. Kjo bëhet me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me Ligjin për Tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Nga gjithsejtë 3,981 prona, komuna gjatë vitit ka arritur të verifikoj vetëm 101 ose 2.5%. Mos azhurnimi i sistemit me të dhëna (verifikim të pronave), ishte si pasojë e mungesës së zyrtarëve anketues në terren.

Rreziku Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se verifikimi të bëhet në baza të rregullta vjetore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, që reflekton shënime të përditësuara të regjistrit dhe ngarkesave të sakta tatimore.

3.3 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 860,877€, ndërsa shpenzimet ishin prej 834,645€ apo 97%.

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar nga Ministria e Financave. Kontrollat kyçe duhet të konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave, si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjëseve, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera dhe aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga asambleja komunale. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i punonjësve të miratuar nga komuna është 136, ndërsa numri aktual i punonjësve është 125. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit si dosjet e personelit për të verifikuar rregullsinë e tyre.

Çështja 4 - Mungesë e dokumentacionit relevant në dosjen e personelit

- E gjetura** Gjatë testimit të dosjeve të personelit identifikua se në disa raste mungonin dëshmitë relevante, si:
- Në një rast Drejtorit të Gjinnazit i kishte skaduar kontrata me 02/05/2017 dhe në bazë të të dhënave nga lista e pagave, i njëjti edhe me tej ishte në funksion të detyrës si dhe është kompensuar me pagë të njëjtë; dhe
 - Në një rast tjetër në dosjen e të punësuarit gjetëm diplomën e pa-nostrifikuar nga ana e Ministrisë së Arsimit.
- Rreziku** Në mungesë të kontrolleve në menaxhimin e personelit, përfshirë dosjet e personelit të pakompletuara (kontratave të skaduara dhe mungesa e dëshmitëve mbi kualifikimin e të punësuarve) do të rezultojnë më kompensime të parregullta si dhe e rrezikojnë cilësinë e procesit arsimor në përgjithësi.
- Rekomandimi 4** Kryetari i komunës duhet të siguroj se para skadimit të kontratave të punëtorëve të fillohet me procedurat e rekrutimit apo nëse paraqitet nevoja për vazhdimin e kontratave, procedurat e vazhdimin të jenë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet në fuqi. Po ashtu në bashkëpunim me drejtoret e shkollave duhet të sigurohet që stafi i angazhuar të ketë kualifikimin e duhur si dhe dëshmitë valide që vërtetojnë nivelin e tyre.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti aktual për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe shpenzimet komunale ishte 221,908€, ndërsa shpenzimet për vitin 2017, ishin 200,949€ ose shprehur në përqindje 91% e buxhetit.

Çështja 5 - Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta dhe detyra specifike

E gjetura Komuna gjatë vitit 2017 kishte angazhuar 18 punonjës përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe detyra specifike. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime.

Në gjashtë raste kemi vërejtur se kontratat ishin lidhur për pozita të rregullta të punës (mësimdhënës dhe doktor) e jo për ekspertë të fushave përkatëse.

Rreziku Lidhja e kontratave për shërbime të veçanta për pozita të zakonshme ndikon në rritjen e shpenzimeve të shërbimeve kontraktuese dhe kjo tregon që shërbimet të mos jenë reale me nevojat e komunës.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj që punonjësit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

Çështja 6 - Mos arsyetimi i avanseve si dhe kodifikimin i gabuar i shpenzimeve

E gjetura Sipas të dhënave të thesarit shpenzimet nga kredit kartela për Kryetarin e Komunës për vitin 2017 ishin 3,652€. Kryetari ka arsyetuar shpenzimet në vlerë 2,614€, mirëpo pjesa tjetër prej 1,038€ kanë mbetur shpenzime të paarsyetuara.

Në tri raste të testuar në vlerë prej 2,418€ janë paguar avanse për udhëtime zyrtare, ndërsa në dosjen e pagesës mungonin ftesat dhe agjendat për këto udhëtime.

Pagesa në vlerë prej 5,095€ për "Furnizim me ushqim për ditën memorialë të turqve" si dhe pagesa në vlerë prej 3,560€, për "Furnizimin me material elektrik për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik" janë regjistruar gabim në kodin ekonomik 13460 "Shërbimet kontraktuese tjera".

Rreziku Mungesa e dokumenteve të nevojshme që arsyetojnë shpenzimet e realizimit të udhëtimeve zyrtare si dhe mos arsyetimi i kredit kartelave mund të rezultojë në shpenzime të paarsyeshme dhe të parregullta. Regjistrimi i shpenzimeve në kode joadekuate rritë rrezikun për mosparaqitje të drejtë të shpenzimeve sipas planit kontabël të shpenzimeve.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese në lidhje me pagesat në avanse dhe të vendos kontrole për të mbështetur validitetin e tyre. Po ashtu të sigurojë shpenzimet evidentohen sipas planit kontabël dhe shpenzimet regjistrohen nëpër kodet përkatëse.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere është 6,466€, prej të cilave në 2017 janë shpenzuar 6,350€, ose 98%. Shpenzimet nga kjo kategori ekonomike kanë të bëjnë me subvencionimin e lehonave.

Çështja 7 - Mungesa e rregullores për subvencione

E gjetura Përkundër rekomandimeve të dhëna në raportet e viteve paraprake dhe zotimit të komunës për hartimin e rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, e njëjta ende nuk është nxjerrë nga komuna. Në mungesë të rregullores, subvencionet janë ndarë në bazë të vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe që të gjitha shpenzimet ishin bërë për subvencionimin e lehonave⁵.

Rreziku Mungesa e rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve krijon paqartësi në përcaktimin e kriterëve për përfituesit e subvencioneve. Kjo rritë rrezikun që subvencionet të mos arrijnë qëllimin e tyre.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të hartoj një rregullore e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim dhe e njëjta të aprovohet në Kuvend Komunal.

⁵ Për secilën lehonë në Komunën e Mamushës ndahen subvencione në vlerë 100€.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 781,576€. Prej tyre në vitin 2017 janë shpenzuar 553,847€, apo 71%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, si dhe objekteve shkollore. Në krahasim me vitin e kaluar, vërehet një ekzekutim më i mirë nga kjo kategori prej 223,128€.

Çështja 8 – Dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave

E gjetura Programi për Investime Publike përfshinë disa projekte në vazhdim nga vitet e kaluara. Disa nga projektet nuk kanë mundur të finalizohen për shkak të moseliminimit të problemeve pronësore apo pengesave tjera, si:

- Te, “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës, Kycja në Autostradë” në vlerë 183,500€, projekti ka përfunduar mbi 99%, mirëpo për shkak të problemeve pronësore nuk është mundur që të bëhet finalizimi apo kycja në Autostradën “Rrugën e Kombit”;
- Te, “Ndërtimi garazhës për automjete të zjarrfikësve” dhe pse projekti ka përfunduar mbi 90%, për shkak të pengesave të rrjetit elektrik nuk ka mundur të finalizohet; dhe
- Projekti “Rregullimi i Qendrës në Mamushë” në vlerë 20,000€ nuk është realizuar për shkak të pengesave të trafos dhe rrjetit të tensionit të lartë.

Rreziku Vonesat në realizimin e projekteve, kanë efekt negativ mbi shpenzimin e buxhetit, duke ndikuar në bartjen e obligimeve nga viti në vit, si dhe mos shfrytëzimin e përfitimeve të parapara të qytetarëve nga shërbimet që ato ofrojnë.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën në vazhdimësi. Po ashtu në të ardhmen duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve fillimisht të zgjidhen çështjet e shpronësimeve, dhe problemeve tjera të identifikuara në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Për vitin fiskal 2017 komuna kishte planifikuar të zhvillojë 57 procedura të prokurimit, nga të cilat janë realizuar 44. Përpos tyre janë realizuar edhe pesë procedura të cilat nuk qenë të përfshira në planin e prokurimit por për të cilat është njoftuar AQP sipas Ligjit të prokurimit në fuqi.

Çështja 9 - Ndarje jo adekuate e detyrave, dhe mos përshkrimi i raportit standard të pranimit

E gjetura Tek pagesa në vlerë 1,120€ për kontratën “Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat e QKMF-së”, i gjithë procesi i realizimit, nga porosia deri të pranimit i mallit, bëhej nga menaxheri i kontratës. Sipas zyrtareve komunal, ndarja jo e mirë e detyrave kishte ndodh si pasojë e mungesës të stafit.

Ndërsa, tek pagesat “Furnizim me traktor” në vlerë 13,500€ dhe “Furnizimi me klima për QKMF” në vlerë 1,120€, raporti standard i pranimit nuk kishte përshkrim mbi furnizimin apo kryerjen e shërbimeve, mirëpo vetëm ishte nënshkruar nga zyrtari pranues pa asnjë koment. Mungesa e informacionit të detajuar ishte si pasojë e trajnimeve të pa mjaftueshme apo edhe neglizhencës së zyrtareve.

Rreziku Mungesa e një komisioni të pranimit të mallit, si dhe mungesa e informacioneve në raportet standarde të pranimit, paraqet rrezik që mallrat/shërbimet e pranuar të mos jenë në përputhje me kushtet e kontratës.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të siguroj ndarje të drejtë të detyrave, kontrole adekuate mbi pranimin e mallrave/shërbimeve para ekzekutimit të pagesave, si dhe duhet të sigurojë se zyrtari i pranimit bën përshkrimin e mallit/punës të pranuar me qëllim të konfirmimit se furnizimet/punët janë pranuar konform kontratës nga ana e zyrtarëve kompetent.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Menaxhimi i pasurive në komunë vazhdon të mbetet sfidë. Komuna nuk ka bërë regjistrimin e pasurive mbi 1,000€ në regjistrin kontabël në SIMFK dhe regjistrimet e pasurive nën 1,000€ në sistemin E-pasuria.

Çështja 10 - Mungesa e regjistrimit të pasurive

- E gjetura** Përkundër rekomandimit të dhënë në raportin e vitit paraparak dhe zotimit të komunës për ta zbatuar, ende nuk është marrë asnjë veprim për të regjistruar pasuritë e komunës. Kjo është shumë shqetësuese, sepse zyrtari i pasurisë është rekrutuar qysh prej vitit 2015, mirëpo ende nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim për regjistrimin e pasurisë së komunës. Si pasojë komuna nuk ka kurrfarë evidencash për pasurinë mbi 1,000€, nën 1,000€ si dhe stoqet.
- Rreziku** Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrin kontabël vështirëson menaxhimin dhe përdorimin e drejtë të pasurive, si dhe vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre. Në mungesë të evidencave ekziston rreziku potencial që pasuritë të keqpërdoren, madje të humben dhe tjetërsohen pa u vërejtur nga menaxhmenti.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të ndërmerr masa të menjëhershme për të regjistruar të gjitha pasuritë e saj. Pasuritë mbi 1,000€ duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Në fund të vitit, para hartimit të pasqyrave financiare duhet të kryhet procesi i inventarizimit i cili duhet të harmonizohet me regjistrat e pasurisë dhe nëse ka diferenca ato duhet të eliminohen. Lidhur me këtë proces të analizohet fillimisht nëse ka nevojë për trajnime për Zyrtarin e Pasurisë.

3.10 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Çështja 11 - Depozitimi i parasë së gatshme

- E gjetura** Rregullorja financiare për të hyrat 03/2010 përcakton se organizatat buxhetore kanë të drejtën e mbledhjes së të hyrave në formë të parasë së gatshme deri në shumën 10€. Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arka duhet të depozitohen në llogaritë përkatëse të autorizuara. Ne kemi konstatuar se shuma prej 695€ që i përket të hyrave nga kadastra, të mbledhura nga data 08/03/2017 deri 21/03/2017 ishte deponuar me datën 22/03/2017, me vonesë 1 deri 13 ditë.
- Rreziku** Depozitimi i vonuar i parasë së grumbulluar në arka rritë rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike. Gjithashtu kjo shpie të raportimi jo i drejtë i periudhës kohore të grumbullimit të tyre. Përveç kësaj, një praktikë e tillë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- Rekomandimi 11** Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
-

3.11 Të arkëtueshmet

Komuna e Mamushës ka shpалosur në PFV si llogari të arkëtueshme vlerën prej 133,000€. Prej tyre të hyra nga tatimi në pronë 93,000€, si dhe taksat në firmë 40,000€. Krahasuar me vitin e kaluar kjo llogari ishte rritë për 15,000€ Ne kemi bërë krahasimin në mes saldove fillestare në fillim të vitit dhe shumës së paraqitur në PFV duke shtuar ngarkesën dhe zbritur pagesat për këtë vit për tu siguruar se vlerat e paraqitura në PFV janë të sakta.

Çështja 12 - Nënvlërësim i llogarive të arkëtueshme të shpалosura në PFV

E gjetura Komuna nuk kishte një regjistër të saktë të kartelës së llogarive të arkëtueshme nga taksat në firmë, përkatësisht nuk është marrë si pikënisje saldo përfundimtare e vitit 2016. Saldo fillestare e të arkëtueshmeve ishte 33,241€, kur i shtohet faturimet e vitit 2017 në vlerë 11,533€ si dhe zbritën arkëtimet e vitit 2017 në vlerë 1,020€, saldo përfundimtare e tyre duhej të jetë në vlerë 43,754€, derisa komuna ka paraqitur vlerën 40,000€, duke nënvlerësuar vlerën e të arkëtueshmeve për 3,754€.

Rreziku Në mungesë të evidencave të sakta ekziston rreziku i shlyerjes së llogarive të arkëtueshme duke favorizuar tatimpagues të caktuar. Kjo përpos dëmtimit të buxhetit komunal mund të paraqet rrezik edhe për trajtim jo të barabartë për tatimpaguesit.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme. Fillimisht duhet të ekzistojë një sistem i përshtatshëm i regjistrimit dhe raportimit të tyre si dhe të sigurojë se do të merren të gjitha veprimet e nevojshme për të rritur nivelin e inkasimit të të arkëtueshmeve.

3.12 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve nga 55,000€ sa ishin në fund të vitit 2016 janë zvogëluar në 12,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Komuna ka raportuar rregullisht në Ministrinë e Financave siç kërkohet me Rregullën Financiare 02/2013 MF për raportimin e obligimeve të papaguara, mirëpo cilësia e raportimit duhet të përmirësohet edhe me tutje.

Çështja 13 - Nën vlerësim i obligimeve

E gjetura Në katër⁶ pagesa të testuara të cilat janë ekzekutuar në vitin 2018, në vlerë totale 2,903€ nuk ishin raportuar në raportin e obligimeve të muajit dhjetor 2017. Sipas Zyrtarit Kryesor Financiar kjo ka ndodhur sepse nuk ishin raportuar nga drejtorja përkatëse.

Për me tepër, sipas raportit të muajit dhjetor totali i obligimeve ishte 16,748€, ndërsa në PFV janë prezantuar në vlerë 12,000€ duke i nënvlerësuar për 4,748€.

Rreziku Paraqitja jo e saktë e të dhënave në pasqyrat financiare ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave buxhetore në të ardhmen.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të forcoj kontrollin lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

⁶ Pagesa "Shpenzimet e rrymës" në vlerë 1,500€, Pagesa "shpenzimet e rrymës" 253€, Pagesa "furnizime mjekësore" 765€, si dhe pagesa "Furnizime mjekësore" 385€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, vetëm një ishte adresuar, tri ishin në proces dhe nëntë nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 11 rekomandime (tetë të pa zbatuara dhe tri të tjera ishin në zbatim e sipër).

Çështja 14 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Komuna, ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i tyre monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen.

Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në dobësi në menaxhimin e proceseve operative, përfshirë të hyrat, shpenzimet, pasuritë dhe obligimet.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Sipas standardeve të auditimit të Qeverisjes së mirë, parimet themelore në këtë fushë janë: llogaridhënia, efektiviteti i kontroleve, menaxhimi i rreziqeve, pavarësia e auditimit të brendshëm, koordinimi i ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe zhvillimi i qeverisjes së mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes të komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Komuna nuk kishte arrit t'i zbatoj në shkallën e mjaftueshme rekomandimet e vitit të kaluar.

Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik të zhvillimit dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet komuna.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve të cilat përfshijnë kryesisht menaxhimin e pasurive, të avanseve, të hyrat, dhe të arkëtueshmeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, secili subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm.

Çështja 15 – Mungesa e themelimit të NJAB-së

E gjetura Komuna nuk ka bërë përpjekje të siguroj themelimin e NJAB-së ose që shërbimet e auditimit të brendshëm t'i siguroj nga bashkëpunimi me ndonjë organizatë tjetër buxhetore. Sipas UA 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NJAB në sektorin publik, neni 3 pika 2.1 përcakton se subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm.

Rreziku Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, te kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin, si dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë kërkesat për vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 16 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo efektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Si të tilla aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Rrjedhimisht, PFV-të kanë rezultuar me pasaktësi dhe gabime. Ne kemi identifikuar se kontrollet mbi të hyrat akoma nuk janë mjaft efektive, dhe ka mangësi në kontrolle në disa fusha të shpenzimeve.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsisive.

Rreziku Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos regjistrim të duhur të shpenzimeve në kategoritë adekuat. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në theksim të çështjes, si dhe pasuritë të regjistruhen në SIMFK.		Menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet për të regjistruar shpenzimet në kategoritë adekuate, mirëpo jo edhe për regjistrimin e pasurisë.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të siguroj që është zbatuar plani i miratuar i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Menaxhmenti ka hartuar një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është shumë i ulët.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar kërkesa për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe sistematike.		Pjesërisht i zbatuar, edhe më tutje ishin identifikuar dobësi , përkatësisht nuk është bërë lista e menaxhimit të rreziqeve.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet sa më parë të miratoj një strategji të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, ku do të përcaktohet qartë qasja e menaxhmentit për reagime ndaj rreziqeve. Krahas identifikimit të rreziqeve në nivel operativ dhe strategjik, menaxhmenti duhet të hartoj edhe një plan veprimi ku përcaktohen masat e veprimit për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme.			Nuk janë marr masa.

2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.			Nuk janë marr masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës së UA nr.23/2009, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë komunë tjetër. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.			Nuk janë marr masa.
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marr masa.
3.3 Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuara për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në të ardhmen. Veçanërisht duhet të rris llogaridhënien e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që mbahen evidenca të sakta për shërbimet e kryera nga operatorët.	Po		

3.3.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të siguroj që kontratat të nënshkruhen mbi bazën e kriterëve të qarta dhe të bazuara në ligjin e punës. Zyrtarët e personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.	Po		
3.3.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të hartoj një rregullore dhe të aprovohet në kuvend, e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim.			Nuk janë marr masa.
3.4 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari të siguroj që fazën e planifikimit të buxhetit vjetor të shfrytëzoj të dhënat e viteve të kaluara dhe gjendjen aktuale që planifikimi të jetë sa më real. Përveç kësaj, duhet të monitoroj kontrollet aktuale të aplikuar në realizimin e të hyrave, dhe të evitoj mundësinë e keqpërdorimeve. Mjetet e inkasuara në të gatshme, të dorëzohen në bankë brenda afateve, siç përshihet me udhëzim.			Nuk janë marr masa.
3.5 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të ndërmerr masa dhe të fillohet menjëherë me regjistrimet e pasurive, për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.			Nuk janë marr masa.
3.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.			Nuk janë marr masa.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe për të siguruar se të gjitha pasuritë që janë në pronë të komunës, të regjistrohen dhe prezantohen në PFV.		Menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet për të regjistruar shpenzimet në kategoritë adekuate, mirëpo jo edhe për regjistrimin e pasurisë.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të vendos dha zbatoj mekanizma konkret të llogaridhënies ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Pas pranimit të këtij raporti, ne sugjerojmë që të përgatitet një plan i rifreskuar i veprimit për të zbatuar rekomandimet e këtij viti dhe rekomandimet e vitit të kaluar, duke përcaktuar qartë afatet kohore, veprimet dhe personat përgjegjës për realizimin e këtij plani. Një proces monitorimi, po ashtu duhet zbatohet.		Menaxhmenti ka hartuar një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është shumë i ulët.	
2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Pjesërisht i zbatuar, edhe më tutje ishin identifikuar dobësi , përkatësisht nuk është bërë lista e menaxhimit të rreziqeve.	

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën duke përfshirë koston e strategjisë i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore. Më pas, duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marr masa.
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme për këtë. Po ashtu, të merr masa që raportimet nga ana e ZKF-së të bëhen sipas kërkesave ligjore për progresin fizik të investimeve kapitale.			Nuk janë marr masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, të kryhet nga Ministria e Financave, apo në bashkëpunim me ndonjë komunë tjetër.			Nuk janë marr masa.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar tek kategoria investime kapitale. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marr masa.

3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Gjithashtu, veprime shtesë duhet të ndërmerren për të siguruar se zbritjet për 10,000€ aplikohen në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi tatimin në pronë.			Nuk janë marr masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do të merren masa përmes mekanizmave efektiv për t'i mbledhur borxhet e prapambetura në mënyrë që të rritet inkasimi i të hyrave dhe baza për financimin e projekteve të parashikuara.			Nuk janë marr masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet në veçanti t'i forcoj kontrollet e çertifikimit për të parandaluar të gjitha pagesat që ndërlidhen me artikujt e furnizuar jashtë kontratave, si dhe duhet të vendosë kontrolle që shpenzimet e parasë së imët të bëhen në pajtim me kërkesat të Rregullës 01/2013.	Po		
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të hartoj një rregullore e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim dhe e njëjta të aprovohet në Kuvend Komunal.			Nuk janë marr masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të ndërmerr masa të menjëhershme dhe të filloj procesin e regjistrimit të të gjitha pasurive dhe stoqeve në dispozicion, si dhe të krijoj një regjistër të plotë dhe të besueshëm të pasurive.			Nuk janë marr masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.			Nuk janë marr masa.

Shtojca III: Letër konfirmim



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtuarshmërisë me të gjeturat e Auditimit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Abdüladi Krasniç

Kryetar i Komunës,

Data: 13.Maj.2018, Mamushë,

